

VENDIM
Nr. 468, datë 30.5.2013

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN E *BROADBAND-IT*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e *Broadband-it*, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit të bashkëpunojë me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si dhe me institucionet e tjera për ndjekjen dhe zbatimin e këtij dokumenti.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha